

në *TE Obiliq/Obilić*. Ai jetonte me bashkëshorten Tahiren, dy vajzat dhe djalin. Në datën 21.09.1998, forcat serbe kishin bombarduar fshatin **Zhilivodë/Zilivoda** nga drejtimi i fshatrave fqinj të Prilluzhës/Priluzje dhe Sibocit/Sibovac. Banorët dhe refugjatët, që ishin të strehuar në fshat, të gjithë së bashku e braktisën fshatin dhe u strehuan në pyjet e bjeshkës së *Çiçavicës/Čičavica*. Ahmeti me familjen e vet kishte ardhur me traktor dhe natën e kaluan në pyll. Të nesërmen, më **22.09.1998**, Ahmeti i tha familjes së vet se do të kthehej në fshat për ta lëshuar bagëtinë nga ahuri dhe së shpejti do të kthehej. Familjarët nuk e kishin parë kurrë më. Pas një jave, familjarët mësuan nga një kushëri se Ahmetin e kishin vrarë. Kushëriri Ismeti, më 24.09.1998, në oborrin e shtëpisë së Habib Krasniqit, e kishte gjetur trupin e masakruar të Ahmetit. Ismeti e identifikoi në bazë të rrobave dhe këpucëve. Po atë ditë, e kishte varrosur në varrezat familjare në fshatin Zhilivodë/Zilivoda. Pas lufte, në korrik të vitit 2000, patologët ndërkombëtar i kishin zhvarrosur mbetjet mortore të Ahmetit dhe pas obduksionit më 12.09.2000, familjarët i rivarrosën mbetjet mortore të Ahmetin në të njëjtin vend.

Burimet: deklarata J.K, FDH-19863; ICTY, IT-05-87 (M.Milutinović dhe të tjerë), Ex.P01434, FDH-33273.

Arbesa (Jahir) Shabani

(1997, shqiptare nga Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica)

Arbesa ka pësuar nga një predhë në datën **22 ose 23 shtator** të vitit 1998 në fshatin **Reznik/Resnik**, ku familja e saj ishte strehuar që nga muaji qershor i vitit 1998. E ëma e saj Habibe ishte duke vrpuar përderisa predhat binin përreth saj. E mbante Arbesen ngrykë, ndërkaq prapa saj ishte vajza e madhe Mirjeta. Përderisa iknin me vrap rrugës, një cifël e granatës e ka qëlluar foshnjën në duart e saj. Aty në rrugë, me vajzën e vdekur në duar e kishte gjetur një polic serb. Ia mori foshnjën e vdekur nga duart dhe e shqelmonte me këmbë sikurse topin. Habibja e ka shikuar e heshtur njeriun i cili ia mëshonte fëmijës së vdekur. Pastaj, e mori vajzën dhe u nis

rrugës drejt shtëpisë së Mustafë Ujkanit, ku ishte strehuar me bashkëshortin dhe fëmijët. Gjatë natës, babai i Arbeses, Jahiri, u kthye në shtëpi nga pylli ku qëndronte i strehuar. E ka çuar trupin e vajzës në Prekaz të Poshtëm/Donje Prekaze dhe e ka varrosur në varrezat e atjeshme.

Burimet: deklarata H.S, FDH-40677; J. Osmani, *Krimet...*, II, 307: ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00700, FDH-33284.

Ajvaz (Hashim) Hasani

(9.11.1962, shqiptar nga Stroci/Strovce, komuna e Vushtrisë/Vuçitrn, punëtor, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Ajvazi kah mesi i vitit 1998 aderoi në UÇK. Më 22.09.1998, forcat serbe iu afruan fshatit të tij [Stroc/Strovce] dhe filluan granatimin. Nëna e tij Tahirja, bashkëshortja e tij shtatzëne Florija dhe tre fëmijët e braktisën shtëpinë me banorët e tjerë të fshatit dhe u nisën më këmbë në drejtim të fshatit Qirez/Čirez [Skënderaj/Srbica]. Ajvazi me pjesëtarët e tjerë të UÇK-së mbetën në fshat. Të nesërmen, më **23.09.1998**, Ajvazi dhe pjesëtarët e UÇK-së u vendosën në fshatin fqinj të **Zhilivodës/Zilivoda**. Po atë ditë, ai ka rënë gjatë luftimeve me forcat serbe. Bashkëluftëtarët e tij e varrosën më 24.09.1998 në fshatin e tij të lindjes.

Burimet: deklarata F.H, FDH-29589; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, october-december 1998, 116, FDH-23857; FDH-36922; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.P01434, FDH-33273.

Azize (Sefer Bazaj) Prokshi

(1915, shqiptare nga Hamidija, komuna e Obiliqit/Obilić, amvise, shtatë fëmijë)

Azizja e moshuar me familje ishin zhvendosur në Zhvilivodë/Zilivoda më 20.09.1998. Në datën **23.09.1998**, filloi granatimi i fshatit Zhilivodë/Zilivoda. Azizja me familje dhe banorët e tjerë të fshatit u zhvendosën në pyllin përmbi fshat [bjeshka e *Çiçavicës/Čičavica*]. Ata u strehuan në vendin e quajtur *Varri i Hoxhës/Hodžin grob*, ku gjendeshin shumë banorë nga **Zhilivoda/Zilivoda** dhe fshatrave përreth. Rreth orës 12:00,